



DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Zyra e Kurikulës dhe Programeve Shumëgjuhësore
440 North Broad Street, Suite 251
Philadelphia, PA 19130
Telephone: 215-400-4240

Nëntor 2014

I dashur Prind/Kujdestar:

Djali/vajza juaj është caktuar si një nxënës i klasës ESOL (Anglishtja për folësit e gjuhëve të tjera) në Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

Bashkëngjitur do të gjeni informacione për shërbimet tona. Ju do të keni një kopje të Programit të Standarteve për Shërbimet e Nxënësve që Mësojnë Anglisht (ELL), të cilat përshkruajnë shërbimet dhe programet që Drejtoria Arsimore ofron për fëmijën tuaj. Gjithashtu do të gjeni Protokollin e Zgjidhjes të Problemeve, ç'ka do të mundësojë se si t'i adresoni shqetësimet që keni.

Gjithashtu ju vëmë në dijeni se, të gjitha shkollat kanë akses në shërbimin telefonik të përkthimit, përmes të cilit ju mund të keni gjithmonë një përkthyes të gatshëm në shkollën e fëmijës tuaj. Shërbimi që ofrohet është **FALAS** dhe përdoret për çdo aspekt të edukimit të fëmijës tuaj.

Në vazhdim, Drejtoria ofron një linjë të gatshme 24 orëshe të destinuar për prindërit dhe familjet që kanë vështirësi në të folurit e Anglishtes, duke i lejuar ata të komunikojnë me Drejtorinë Arsimore të Filadelfias për shqetësimet dhe pyetjet e tyre. Nëse ju telefononi numrin për gjuhën tuaj, ju do të arrini sekretarinë telefonike, ku ju mund të lini mesazh për numrin tuaj të kontaktit, dhe një informacion të shkurtër për pyetjet apo problemin për të cilin ju keni telefonuar. Më pas një person, që flet gjuhën tuaj do t'ju telefonojë, duke ju ndihmuar për zgjidhjen e problemit apo informacionin që keni kërkuar.

Numri i telefonit dhe uebsajti, ku prindi do të gjejë asistencë në gjuhën e shqipe, është në vijim:

Shqip **215 400-8480** <http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/l/language-albanian/help>

Ne shpresojmë në bashkëpunimin tuaj, për mbështetjen e programit tonë ELL.

Sinqerisht,

Allison W. Still
Zëv.Kryetare